



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: [+355 4 2380 300/315](tel:+35542380300315)
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K1/I15-2 Prot.

Tiranë 4.04.2020

Nr. doc. 202002683/2

Lënda : *Sugjerojmë marrjen e masave të domosdoshme, të menjëhershme, për komunitetet Rome dhe Egjiptiane.*

Drejtuar : **Bashkisë Tiranë**
Bashkisë Belsh
Bashkisë Berat
Bashkisë Bulqizë
Bashkisë Cërrik
Bashkisë Delvinë
Bashkisë Devoll
Bashkisë Dibër
Bashkisë Divjakë
Bashkisë Dropull
Bashkisë Durrës
Bashkisë Elbasan
Bashkisë Fier
Bashkisë Finiq
Bashkisë Fushë-Arrëz
Bashkisë Gjirokastër
Bashkisë Gramsh
Bashkisë Has
Bashkisë Himarë

Bashkisë Kamëz
Bashksë Kavajë
Bashkisë Klos
Bashkisë Kolonjë
Bashkisë Konispol
Bashkisë Korçë
Bashkië Krujë
Bashkisë Kukës
Bashkisë Kurbin
Bashkisë Kuçovë
Bashkisë Këlcyrë
Bashkisë Lezhë
Bashkisë Libohovë
Bashkisë Librazhd
Bashkisë Lushnje
Bashksë Maliq
Bashkisë Mallakastër
Bashkisë Malësi e Madhe
Bashkisë Mat
Bashkisë Memaliaj
Bashkisë Mirditë
Bashkisë Patos
Bashkisë Peqin
Bashkisë Pogradec
Bashkisë Poliçan
Bashkisë Prrenjas
Bashkisë Pukë
Bashkisë Pustec
Bashkisë Përmet
Bashkisë Roskovec
Bashkisë Rrogozhinë
Bashkisë Sarandë
Bashkisë Selenicë

Bashkisë Shijak
Bashkisë Shkodër
Bashkisë Skrapar
Bashkisë Tepelenë
Bashkisë Tropojë
Bashkisë Ura Vajgurore
Bashkisë Vau i Dejës
Bashkisë Vlorë
Bashkia Vorë

Institucioni i Avokatit të Popullit, në ushtrim të mandatit të tij kushtetues, për parandalimin e shkeljes, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, në situatën kritike të fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia Covid-19, ka ndjekur dhe vazhdon të ndjekë me një vëmendje të posaçme, gjendjen e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane dhe masat e marra për sigurimin dhe plotësimin e nevojave të tyre bazike të jetesës, në këtë situatë të paprecedent.

Shqetësimet e bëra publike në media, por edhe nga veprimtarë të shoqërisë civile, evidentojnë mungesa të mjeteve të jetesës, artikujve ushqimorë, dizinfektantëve, si dhe të trajtimit financiar nga ana e strukturave përgjegjëse shtetërore, të individëve dhe familjeve Rome e Egjiptiane, në zonën e Rrapishtës, Elbasan, në fshatin Levan dhe Drizë, Fier, në komunitetet Rome dhe Egjiptiane në Korçë, Shkodër, komunitetin rom, në zonën e ish NISH Tullës, Durrës, etj. Kjo gjendje paraqitet e njëjtë në të gjithë vendin duke përbërë një tregues të qartë se, masat e marra nga ana e institucioneve përgjegjëse, rezultojnë të pamjaftueshme dhe jo proporcionale për të garantuar një jetesë normale, brenda kushteve të vetëizolimit për këto komunitete.

Duhet theksuar se, kuadri ligjor në fuqi konsideron specifikiisht të rëndësishme problematikën që lidhet me jetesën në tërësi të minoritetit kombëtar Rom dhe atij Egjiptian, duke formuluar dhe miratuar strategji kombëtare, si dhe përgjegjësi konkrete për ndërmarrjen e masave pozitive për ndryshimin e kësaj situatë. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.1072 datë 23.12.2015, ka miratuar dokumentin strategjik, “Plani Kombëtar i Veprimit për integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, në Republikën e Shqipërisë, 2016-2020”, ku parashikohen një sërë masash për përmirësimin e kushteve të jetesës së këtyre minoriteteve dhe integrimin e tyre në shoqëri, në afat aplikimi afat shkurtër dhe afat mesëm.

Realiteti i përditshëm që shohim më sytë tanë na ka bërë të reflektojmë thellë dhe të kuptojmë se Romët (pa përjashtuar këtu edhe Egjiptianët), sot janë një grup vulnerabël dhe në risk, sikurse edhe disa kategori të tjera sociale në vend. Avokati i Popullit, prej kohësh ka trajtuar problematikën e këtyre minoriteteve dhe në fakt, pyetja bazë që shtrohet sot nga eksperiencia jonë është nëse realisht janë Romët dhe Egjiptianët, të përfshirë në sistemin tonë social? Dhe kur flasim për këtë sistem kemi parasysh, strehimin, regjistrimin në gjendjen civile, përfitimin e ndihmës ekonomike, apo edhe arsimimin, si problemet më kyçe, pa përjashtuar këtu punësimin, formimin profesional, kujdesin shëndetësor dhe çdo beneficë që sistemi ynë social, ua siguron qytetarëve të vet.

Sistemi ynë social formalisht i pranon këta individë, por faktikisht i përjashton ata duke u kthyer në një pengesë të pakalueshme burokratike dhe sinonim të një refuzimi të pashpallur social.

Por situata aktuale kërkon një tjetër objektiv vlerësimi dhe ritëm shumë më të shpejtë, në masat dinamike që duhet të ndërmerren për komunitetet Rome dhe Egjiptiane në të gjithë vendin, kudo ato ndodhen. Faktikisht jemi para momentit për të bërë një zgjedhje historike, ku barazia formale e garantuar në ligj, të mund të kthehet në një barazi reale thelbësore për këto minoritete, të cilët, ashtu në qetësinë e tyre të përditëshme, por shqetësuese për sytë e një shoqërie demokratike gjithëpërfshirëse, na kujton se ne maxhoranca i kemi lënë “të qetë”, në përjashtimin dhe segregimin e tyre social.

Pikërisht për këtë fakt, sot është koha për të folur me gjuhën e më të dobët, për të gjetur një zgjidhje e cila e integron natyrshëm në këtë gjendje të vështirë këto minoritete, që ende nuk kanë gjetur paqen sociale të merituar. Ndaj kjo zgjidhje mund të vijë duke qënë ne promotorët e përfshirjes së tyre në sistemin tonë social, jo thjesht dhe vetëm përmes garantimit të barazisë formale, por duke aplikuar edhe skema trajtuese favorizuese të përkohëshme, në kuadër të realizimit të një diskriminimi pozitiv për të arritur qëllimin parësor të integritit fillestar, më qëllim sensibilizimin, aktivizimin dhe krijimin e besimit të munguar tek ta.

Ky ka qënë dhe është vizioni i adoptuar në qëndrimet e institucionit të Avokatit të Popullit, ndaj këtyre problematikave shqetësuese.

Familjet e minoriteteve Rome dhe Egjiptiane, ndër vite kanë vuajtur për shkak të privimit të tyre, për punësim, arsimim, mbrojtje sociale etj. Gjendja e tyre aktuale si të pastrehë, të papunë dhe pa shërbime jetësore në çdo hap, rrit dhe përkeqëson edhe më tej gjëndjen e këtyre komuniteteve, e të gjitha këto pasoja nuk çënojnë vetëm këto komunitete, por sjellin efektin e tyre negativ në cilësinë e jetesës për të gjithë qytetarët shqiptarë. Gjendja paraqitet edhe më e rënduar tashmë, kur përjashtimet nga sistemi i ndihmës ekonomike të individëve, apo familjeve Rome dhe Egjiptiane bashkëshoqërohen nga mungesa e regjistrimit të një pjese jo të vogël të tyre (kryesisht Rom), në regjistrat themelore të gjendjes civile, mungesa e punësimit, punësimi individual “në të zezë”, etj.

Në këtë problematikë të gjerë ekzistuese, masat e përgjithshme të marra për të parandaluar infeksionin, të tilla si distancimi shoqëror dhe vetëizolimi, rezultojnë të jenë të pamundura për këto komunitete, duke i ekspozuar pjesëtarët e tyre, drejt varfërisë ekstreme, e cila përshkallëzohet deri në mbijetesë.

Sot nevojitet një vëmendje e angazhim institucional i shtuar, për t’ju përgjigjur nevojave bazike të jetesës së këtyre komuniteteve, e konkretizuar me masa që ndikojnë drejtëpërdrejtë dhe që sigurojnë një standard të pranueshëm jetese në kushtet e kësaj pandemie globale. Ofrimi i ndihmës financiare shtesë, i mjeteve bazë të jetesës, garantimi i ofrimit të shërbimeve bazë sociale dhe aksesit në këto shërbime për këto komunitete, do të përbënin disa nga sugjerimet e institucionit të Avokatit të Popullit, drejtuar organeve të qeverisjes vendore, të cilat do të mundësonin përballimin dhe kapërcimin sa më denjësisht të kësaj situatë.

Më konkretisht sugjerojmë si të nevojshme marrjen e masave nga ana juaj, si organe qeverisëse vendore, në përputhje me funksionet e qeverisjes vendore të përcaktuara në ligjin nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, lidhur me:

- Evidentimin e numrit real të individëve dhe familjeve në nevojë, pjesë e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, të vendosura brenda territorit të njësisë administrative, të administruar nga ana juaj.
- Ofrimin e paketave bazë ushqimore në mënyrë të vazhdueshme periodike, për individët dhe familjet në nevojë të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, të vendosura brenda territorit të njësisë administrative, të administruar nga ana juaj.
- Evidentimin e familjeve dhe individëve, pjesë e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, të vendosura brenda territorit të njësisë administrative, të administruar nga ana juaj, të cilët do të trajtohen me të ashtëquajturën, “pagesë e luftës”.
- Dezinfektimin e vazhdueshëm të mjediseve publike të zonave ku janë vendosur komunitetet Rome dhe Egjiptiane, brenda territorit të njësisë administrative, të administruar nga ana juaj, dhe ofrimin e mjeteve dezinfektuese për individët dhe familjet në nevojë të këtyre komuniteteve.
- Sigurimin e furnizimit pa ndërprerje me ujë të pijshëm, të familjeve dhe individëve të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, të vendosura brenda territorit të njësisë administrative, të administruar nga ana juaj.
- Sigurimin e vazhdueshëm të shërbimeve sociale dhe një vëmendje të shtuar ndaj personave PAK, të moshës së tretë dhe të fëmijëve në këto komunitete.

Në gjykimin e Avokatit të Popullit, mungesa e kushteve minimale të jetesës së anëtarëve dhe familjeve të këtyre komuniteteve është një problem serioz, jo vetëm për ata vet si individë, por edhe për mënyrën e ofruar nga shteti dhe shoqëria jonë për integrimin e plotë të tyre në shoqëri. Kjo situatë bën që, këto komunitete të ndihen të diskriminuar, të pabarbartë me pjesën tjetër të popullsisë dhe me mungesë shprese për të ardhmen.

Çështja në fjalë bëhet edhe më sensitive, pasi kemi të bëjmë me trajtimin e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane dhe respektimit të të drejtave të tyre, si një element i theksuar qartë edhe në pesë prioritetet, që vendi ynë duhet të përmbushë në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin European.

Duke marrë në kohë masat e propozuara, do të jemi në gjendje të parandalojmë një situatë krejtësisht të pamëshueshme duke u gjendur me afër qytetarëve dhe nevojave të tyre në kohën e fatkeqësisë natyrore, dhe nga ana tjetër kontribuojmë realisht në përmbushjen e detyrave të organeve të qeverisjes vendore dhe në respekt të plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Problemet e Romëve dhe Egjiptianëve sot në Shqipëri, nuk janë thjeshtë e vetëm probleme të tyre por një kampanë e fortë për gjithë shoqërinë shqiptare, ndaj zgjidhja e tyre adekuate është në të mirë të shoqërisë sonë.

Askush nuk duhet të lihet prapa në këtë situatë të pazakontë, që kërkon ndërveprim, mbështetje dhe solidarizim shoqëror.

Duke besuar në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj

K O M I S I O N E R I

Vilma SHURDHA